



Prishtinë, 22 dhjetor 2010

Kodi i ZRRE-së: V_324_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14.2 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.034/L-185;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e Ngrrohtores së Qytetit Termokos Sh.a (N.Q Termokos Sh.a) për derogim të **nenit 8.2 (Mjedisi)** të Licencës për Gjenerim të Ngrrohjes Qendrore, të datës 01.11.2010,

në seancën e mbajtur me datë 22 dhjetor 2010, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LEJOHET** N.Q Termokos Sh.a derogimi në zbatimin e **Nenit 8.2 (Mjedisi)** të Licencës për Gjenerim të Ngrrohjes Qendrore, deri me datë **30.06.2011**.

Arsyetim

- ZRRE me datë 01.11.2010 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes N.Q Termokos Sh. a, e cila ka kërkuar shtyrje afati të Neni 8.2 (Mjedisi) të licencës për Gjenerim me Ngrrohje Qendrore.
- N. Q Termokos Sh. a, ka parashtruar kërkesën për Leje Ekologjike Nr. 2215 të datës 17.11.2010 në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ku ka kërkuar ti lëshohet Leja Ekologjike (Mjedisore), e nëse nuk është e mundur t'i lëshohet vendimi i përkohshëm për Leje Ekologjike (Mjedisore).
- Me datë 01.12.2010 Inspektorati i MMPH ka dhënë një përgjigje me shkrim (përgjigjja Nr. 2551-2/09) ku janë sqaruar arsyet ligjore që duhet të plotësohen sipas legjislacionit në fuqi, ku pas marrjes së Vendimit për Pëlqim Mjedisor, sipas nenit 31 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr/03/L-025, nëse plotësohen kushtet sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor, ndërmarrja N.Q Termokos Sh.a, mund të pajiset me Leje Ekologjike nga MMPH.
- ZRRE ka vlerësuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ndërmarrja N. Q Termokos Sh.a dhe pas plotësimit të dëshmive të kërkuara, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

- II. Kërkoheh nga i licencuari, që brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, të ndërmerh të gjitha veprimet e nevojshme për plotësimin e kushteve për marrjen e Pëlqimit Mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- III. Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencës së N.Q Termokos Sh.a-së mbesin në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar